

FJALA E DEPUTETIT ENKELEJD ALIBEAJ

E ENJTE 15 SHTATOR 2022

Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë,

Zakonisht, kur kalohen për diskutim në parlament çështjet e marrëveshjeve ndërkombëtare, diskutimi është gjithmonë përciptas, kalohen shpejt e shpejt. Ka qenë gjithmonë vota e opozitës (e kësaj opozite, po e po), për një arsye shumë të thjeshtë: bëhet fjalë për fytyrën, për imazhin e Shqipërisë në arenën ndërkombëtare. Ky ka qenë qëndrimi ynë dhe do të jetë edhe për këto marrëveshje. Megjithatë, duke qenë se janë marrëveshje ndërkombëtare dhe shpeshherë nuk janë lehtësisht të perceptueshme për publikun, dy gjëra do të duhet t'i themi edhe për këto marrëveshje. Çfarë është kjo marrëveshje me Emiratet e Bashkuara Arabe? Emër i gjatë.

Në fakt, mund të gjejmë një emër tjetër dhe menjëherë do të kujtohet në mendjet e shqiptarëve se për çfarë bëhet fjalë. Ju thotë gjë Dubai? Banda e Durrësit, ju thotë gjë? Banda e Elbasanit, ju thotë gjë? E pra, të gjitha bandat në këtë vend kanë gjetur parajsën e tyre në Dubai, në Emiratet e Bashkuara Arabe. Sigurisht, ministrin e Brendshëm, që po lexon, e kuptoj kur thotë: “Po, unë e kam bërë punën time. Kemi lidhur edhe një marrëveshje!”. Po çfarë është kjo marrëveshje? A e dini çfarë është kjo marrëveshje? Është shkëmbim të dhënash, janë ato që kanë dalë në mexhllis, të dhënat që i ka sot kushdo në internet dhe me 400 dollarë i merr kur të dojë, të banditëve, të krimeve që kanë kryer, të rrjetit kriminal; del gjithçka!

A quhet kjo arritje?! Arritje e vërtetë do të duhet të ishte imazhi i Shqipërisë teksa Emiratet e Bashkuara Arabe kanë kërkuar këtë marrëveshje, pra e kanë kërkuar ata, dhe kjo është një çështje e rëndësishme për ta kuptuar, që do të thotë se atyre u ka lindur një problem dhe kanë kërkuar këtë lloj marrëveshjeje reciprociteti, dhe dinjiteti i shtetit shqiptar do të duhet të kërkonte gjënë tjetër: marrëveshjen e ekstradimit. E dëgjova ministrin e Drejtësisë qepar, që tashmë nuk ndodhet këtu, i cili nuk tregoi një provë të vetme nëse ka kërkuar një marrëveshje

ekstradimi me Emiratet e Bashkuara Arabe. Ky është qëndrim dinjitoz? Ky është vullnet për të luftuar krimin?

Kjo është një çështje shumë e rëndësishme, që tregon qartësisht mungesë vullneti për të luftuar krimin në atë parajsë kriminale. Po, është e vërtetë ajo që Salianji ka thënë: “Këtu kërcet dyfeku, atje hapet shampanja”, mjafton të pyesni gazetarët e kronikës. Lexojini raportet e një medieje serioze, siç është BIRN-i, që i tregon të gjitha rastet. Kjo është një kampanë alarmi që do të duhet të bjerë, së pari, në veshin e ministrit të Brendshëm dhe, së dyti, në veshin e ministrit të Drejtësisë. Çfarë është kjo, mungesë rakordimi apo është kapje nga krimi? Kjo është parajsja kriminale sot për banditët shqiptarë, që duhet të na bëjë të gjithëve të mendohemi.

Po jua them që tani: nëse do të sillni një marrëveshje ekstradimi me Emiratet e Bashkuara Arabe, do ta keni votën tonë. Së dyti, që është akoma më e rëndësishme, problemi më i madh i kësaj mungese të marrëveshjes së ekstradimit janë pengesat që i keni nxjerrë SPAK-ut, reformës në drejtësi. Ata e kanë thënë edhe në raportimet që kanë ardhur në parlament se ka një problem me zgjatjen e procedurave, me burokracitë, ndërkohë që Shqipëria ka një eksperiencë shumë të mirë ndër vite për të lidhur marrëveshje dypalëshe për ekstradimin. E pra, ndanë kësaj marrëveshjeje kaq të thjeshtë me Emiratet e Bashkuara Arabe fshihen kaq probleme të mëdha dhe, së dyti, një demaskim kaq i madh i qeverisë shqiptare!

Kjo është ajo çfarë duhet të diskutojmë të gjithë së bashku, për t’i zbardhur faqen vendit. Kjo gjë duhet parë me shumë seriozitet, duhet parë si impuls politik, si sinqeritet për të luftuar krimin, për të hequr çfarëdolloj ideje keqkuptimi, që pengimi i marrëveshjes së ekstradimit me Emiratet e Bashkuara Arabe të jetë akaparuar nga krimi. Shiheni edhe kështu! E kanë detyrim për ta bërë këtë, si ministri i Brendshëm dhe ai i Drejtësisë, gjithashtu, edhe Kryeministri, por ai fluturon lart, si gjithmonë! Parajsja kriminale është atje. Detyrimi juaj është të tregoni që nuk jeni të kapur nga krimi dhe të filloni një orë e më parë kërkimin e kësaj marrëveshjeje. Vullnet i qartë politik! Nga ana jonë, do ta keni votën sapo ta sillni, edhe për këto marrëveshje, edhe pse janë pa asnjë lloj vlere. “Shkëmbim të dhënash”!

E dimë fare mirë, mjafton të pyesësh gazetarët dhe jua thonë ata fije e për pe se ku ndodhet njëri dhe ku ndodhet tjetri. Çështja është si do t’i sjellim para drejtësisë dhe t’i çojmë në burg!

Ky është shtetit i së drejtës! Kjo është lufta kundër krimit! Ky është vullneti politik! Për këtë ia vlen të qëndrosh aty. E pra, kaq e thjeshtë është, nuk është sfidë për ju, për askënd, por është thjesht një qëndrim për t'i zbardhur faqen Shqipërisë dhe për të respektuar qytetarët shqiptarë. Këto fjalë mund t'ju hyjnë nga njëri vesh e t'ju dalin nga tjetri, por shumë shpejt, sa të krisë sërish kallashi i radhës, është më mirë ta themi që sot, do t'i bënim nder vendit edhe në rrugën drejt integritit europian, që kjo është një nga kërkesat kryesore. Kështu bëhet shteti. Faleminderit!